



# “ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS – REALITET PËR ÇDO FËMIJË”



Save the Children



AGENZIA ITALIANA  
PER LA COOPERAZIONE  
ALLO SVILUPPO



MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Raporti i Konferencës Rajonale  
“Arsimi Gjithëpërfshirës  
Realitet për Çdo Fëmijë”  
Tiranë, 29 Maj 2017

## Hyrje

Në datën 29 maj 2017, Save the Children Albania, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit organizoi konferencën rajonale “Arsimi Gjithëpërfshirës realitet për çdo fëmijë”.

Në fokus të kësaj konference ishte aksesimi dhe cilësia e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri dhe në rajon.

Qëllimi kryesor i kësaj konference ishte ndërgjegjësimi i politikëbërësve, i institucioneve zbatuese të politikave arsimore, institucioneve kërkimore, akademikëve dhe aktorëve të tjerë për nevojën e zbatimit dhe mbështetjen e praktikave më të mira që garantojnë dhe promovojnë të drejtën për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, me fokus ofrimin e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Kjo konferencë u organizua në kuadër të aktivitetit përmblyës të projektit “Arsimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri” e financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim e zbatuar nga Save the Children Shqipëri në partneritet me MEDPAK dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Ky projekt 3-vjeçar, rezultatet e të cilit u prezantuan në konferencë, u financua nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim, bazuar në përvojën e suksesshme të një projekti të ngjashëm të zhvilluar më parë në Kosovë. Për këtë arsye, konferenca u fokusua në ndarjen e përvojave mes vendeve të rajonit, arsye për të cilën kjo konferencë u ndoq edhe nga përfaqësues të Ministrive të arsimit të Kosovës, Bosnjë dhe Hercegovinës, Gjeorgjisë dhe Armenisë si dhe Italisë

Konferenca u moderua nga **znj. Daniela Marassi**, Këshilltare Teknike e Arsimit në Save the Children Italy.

## Mirëseardhja dhe fjalët përshëndetëse

Në seancën e mirëseardhjes së kësaj konference morën pjesë dhe përshëndetën znj. Mirela Karabina, Ministre e Arsimit dhe

Sportit e Shqipërisë, znj. Anila Meço, Drejtore e Save the Children në Shqipëri, Sekretari Permanent i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, z. Alush Istogu, z. Nino Merola, përfaqësues i Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim dhe z. Ahmet Kryeziu, drejtori i Save the Children Kosovë.

Znj. Anila Meço, drejtore e Save the Children Shqipëri e nis fjalën e saj, pasi të pranishmit dëgjuan kërkesat e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga zona të ndryshme të vendit. Duke iu referuar kërkesave të Megit, Sonjës, Elkidit, Ejonës, por edhe shumë fëmijëve të tjerë me aftësi të kufizuara nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, nga zona rurale dhe urbane, znj. Meço u shpreh se kërkesat e këtyre fëmijëve tregojnë qartë se sa i nevojshëm e i rëndësishëm është arsimi gjithë, si mundësi për të nxënë, për të zhvilluar vetëbesimin, për të thyer barrierat dhe për të hapyer dyert drejt një jete më të mirë. Por, theksoi, znj. Meço, jo të gjithë fëmijët e kanë mundësinë për ta bërë realitet ëndrrën e tyre për t'u arsimuar, ndërsa edhe për ata fëmijë me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin, ecuria dhe gjithëpërfshirja mbeten ende sfidë.

Znj. Meço prezantoi ndërhjetet e ndërmarrura nga Save the Children në kuadër të projektit “Sipas vlerësimeve dhe raporteve të fundit rezultojnë se rreth 30% e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK), të moshës 6-18 vjeç, aktualisht nuk janë në shkollë. Në 7 rajonet e Shqipërisë, ku Save the Children aktualisht punon, si: Burreli, Durrësi, Gjirokastra, Peshkopia, Vlora, Elbasani dhe Korça, vetëm 15% e fëmijëve me AK, që ndjekin arsimin bazë, kanë mësues ndihmës. Numri i fëmijëve të vlerësuar nga Komisionet Multidisiplinare pranë Drejtorive Rajonale Arsimore (DAR) është vetëm 6.5%. Kopshtet dhe shkollat kanë ende pengesa infrastrukturore, që i bën të paaksesueshme për fëmijët me AK si dhe ka mungesë të mjeteve didaktike të përshtatshme për nevojat individuale të fëmijëve me AK.

Në këto rajone, mungojnë ndërhyrjet e koordinuara ndërmjet institucioneve arsimore, shërbimeve sociale dhe shëndetësore që sigurojnë trajtim multidisiplinar të nevojave

të fëmijeve me AK dhe mundësojnë gjithëpërfshirjen në shkollë dhe komunitet. Shpesh, prindërit janë rezistentë ndaj ekspozimit të fëmijëve të tyre në komunitet nga frika e stigmatizimit dhe bulizmit.

Vitet e fundit, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka bërë përpjekje të shumta për reformimin cilësor të sistemit parauniversitar, reforma të cilat përfshijnë legjislacionin, kurrikulat e reja, infrastrukturën dhe, së fundmi, edhe reformimin e burimeve njerëzore me ligjërimin e mësuesit ndihmës. Të gjitha këto reforma e masa u vijnë në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ndihmojnë për të garantuar të drejtën e fëmijëve për akses dhe cilësi në arsim. Por sfidë mbetet zbatimi dhe vënia në funksion e këtyre reformave në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ndaj Save the Children Shqipëri, vijoi zonja Meço, në kuadër të projektit projektit “Arsimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri”, projekt, i cili financohet nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe që zbatohet nga Save the Children dhe MEDPAK, iu është përgjigjur nevojave të MAS në zbatim të reformave dhe për të kontribuar në përmirësimin e situatës në arsim të nxënësve me aftësi të kufizuara. Ky kontribut për periudhën 3-vjeçare 2014-2017 është përqendruar në 7 rajone të vendit: Peshkopi, Burrel, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë, në zona urbane dhe rurale, në 14 shkolla dhe kopshte, ka mundësuar:

- Ngritjen e mekanizmave të hershëm identifikues dhe mbështetës për fëmijët me AK. Në ndihmë të këtij mekanizmi u realizua krijimi dhe përdorimi i një **datbazë** për institucionet arsimore, që ndihmon identifikimin dhe ndjekjen e progresit të fëmijëve me AK dhe vështirësi në të nxënë.
- Ngritjen e kapaciteteve të 84 anëtarëve të Komisioneve Multidisiplinare mbi vlerësimin e nevojave të fëmijëve me AK, sipas **Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionalitetit (FNK)**
- Ngritjen e kapaciteteve të **577** mësuesve dhe **132** mësuesve ndihmës mbi realizimin e metodologjisë dhe didaktikës gjithëpërfshirëse.
- Si rezultat i ngritjes së kapaciteteve

të këtyre mësuesve deri tani kanë përfituar rreth **401** fëmijë me AK dhe **100 %** e tyre janë vlerësuar nga komisionet multidisiplinare rajonale dhe janë mbështetur me plane edukative individuale.

- Në ndihmë të mësuesve, prindërve dhe anëtarëve të komisionit multidisiplinar pranë DAR dhe shkollës, është hartuar një paketë re e **Planit Edukativ Individual** në përputhje me standardet botërore të didaktikës gjithëpërfshirëse dhe janë zhvilluar **Instrumente të vlerësimit të fëmijëve me probleme neurozhvillimore të moshës 5-10 vjeç**.
- Në **21 kopshte dhe shkolla janë ndërtuar rampa dhe janë përshtatur ambientet e brendshme** për të siguruar aksesueshmërinë e fëmijëve me AK.
- Ndër kontributet më të suksesshme të Save the Children është nxitja bashkëpunimit efektiv mes Universitetit të Korçës dhe Elbasanit, të cilët përmes ekspertizës së ofruar nga Universiteti i Bolonjës, arritën rishikimin e të gjitha programeve dhe kurrikulës në degën e Edukimit. Falë këtij bashkëpunimi Universiteti i Korçës dhe Elbasanit kanë ngritur dhe zhvilluar një **program master të mësuesisë me profil minor mësuesin ndihmës**. Ky program do t’ju vijë në ndihmë të gjithë mësuesve të arsimit parauniversitar për të garantuar zhvillimin dhe progresin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla dhe kopshte.
- Për të ndikuar në ndërgjegjësimin e komunitetit mbi të drejtat për arsimim të çdo fëmije me fokus fëmijët me AK, u organizuan fushata ndërgjegjëse me pjesëmarrjen aktive të **7000 fëmijë dhe 4700 prindërve**.

Pavarësisht nga këto arritje, theksoi znj. Meço, mbetet ende shumë për t’u bërë në këto rajone, por edhe në nivel kombëtar për të garantuar të drejtën themelore për arsim dhe zhvillim të fëmijëve me AK. Ndaj në mbyllje të fjalës së saj, znj. Meço renditi një sërë rekomandimesh që Save the Children i sjell si mësim të nxjerra nga ky projekt. Këto

rekomandime lidhen me:

- rritjen e investimeve publike në arsim, në nivel qendror dhe bashkiak, që garantojnë akses dhe cilësi në arsim për fëmijët me AK dhe sigurojnë zbatimin e praktikave të mira.
- përcaktimin e linjave buxhetore që i përgjigjen nevojave të fëmijëve me AK dhe shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve për shërbime rehabilituese, mjete didaktike, pajisje mbështetëse, dhe transport të përshtatshëm për çdo fëmijë.
- krijimin e mekanizmave që sigurojnë funksionimin e komisioneve multidisiplinare pranë DAR/ZA dhe bashkëpunimin mes Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, Komisioni pranë DAR/ZA-së si dhe komisionit pranë institucioneve arsimore për punën me fëmijët me AK.
- garantimin e formimit profesional të Komisioneve Multidisiplinare pranë DAR /ZA-së, mbi vlerësimin e fëmijëve me AK dhe ofrimin e praktikave mbështetëse në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe funksionimit të aftësisë së kufizuar.
- garantimin e zbatimit të ligjit Parauniversitar, neni 57, për rekrutimin e mësuesve ndihmës me kualifikim përkatës si dhe sigurimin e kualifikimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe përshtatjen e metodave pedagogjike me nevojat individuale të fëmijëve me AK.
- transformimin e shkollave speciale në qendra burimore të specializuara të cilat do të ofrojnë shërbime rehabilituese dhe do të aftësojnë fëmijët me AK për një jetesë të pavarur.
- ndërgjegjësimin e komunitetit mbi normat kulturore/sociale për të garantuar qëndrime pozitive ndaj fëmijëve me AK si dhe përmirësimin e mekanizmave të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të prindërve të fëmijëve me AK në të gjitha nivelet e qeverisjes (Bordet e Shkollave, Komisionet Vlerësuese etj).

Znj. Meço konfirmoi se Save the Children do të vijojë të kontribuojë për arsimin gjithëpërfshirës me fokus fëmijët me aftësi

të kufizuara edhe në tri vitet e ardhshme, kryesisht për identifikimin dhe stimulimin e hershëm të fushave të zhvillimit të fëmijëve duke ndihmuar për ngritjen e kapaciteteve të mjekëve pediatër në konsultore dhe të edukatorëve dhe mësuesve në kopshte dhe çerdhe. Gjithashtu, Save the Children, do të ndihmojë në përmirësimin e infrastrukturës duke ndërtuar dy çerdhe të reja në Elbasan dhe Korçë dhe do të punojë për hapjen e programeve të reja për moshën 0-3 vjeç. Universiteti i Korçës dhe i Elbasani, që këtë vit, kanë aplikuar për akreditimin e programeve universitare për kujdesin ditor dhe fëmijërinë e hershme, të cilat do të ndihmojnë në zbatimin dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve.

Znj. Meço e mbylli fjalën e saj duke thënë se Save the Children beson se duke investuar në arsimimin e fëmijëve, mund të realizohet vizioni për akses, por ç'është më e rëndësishmja, të përmirësohet cilësia në arsim për të kontribuar kështu në krijimin e një gjenerate të arsimuar, të aftësuar, të vlefshme për veten dhe për shoqërinë.

Edhe pse vetëm pak ditë pas marrjes së detyrës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina shprehu kënaqësinë e veçantë për pjesëmarrjen në këtë konferencë, e cila adreson në mënyrën më të mirë mundshme një nga parimet më të rëndësishme të arsimit, gjithëpërfshirjen.

Ministria shprehu ndjeshmërinë e saj për fëmijët me nevoja të veçanta dhe ndau me të pranishmit mbështetjen që ajo vetë iu kishte ofruar fëmijëve me AK në institucionet që kishte drejtuar.

Ajo u shpreh e kënaqur që në daljen e parë publike pas marrjes së detyrës u njoh me rezultatet e punës së këtij projekti, i cili ka në fokus fëmijët me AK.

Ministria Karabina theksoi se ishte shumë e rëndësishme të rritet mbështetja për shkollat për gjithëpërfshirjen, por edhe të rritet ndjeshmëria publike për këtë çështje.

Më tej, Ministria Karabina shprehu falënderimet për organizatat e angazhuara në

zbatimin e këtij projekti, i cili kishte një shtrirje demografike në zonat më të rëndësishme të vendit si: Peshkopi, Burrel, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë. Falë mbështetjes së projektit “Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në Shqipëri” me mbështetjen edhe të MEDPAK, MAS ka mbështetur 30 institucione arsimore parauniversitare me mekanizma të identifikimit të hershëm. Ministrja Karabina u shpreh se parimet ligjore të gjithëpërfshirjes duhen bërë realitet, pasi kjo është nevoja e nxënësve dhe mësuesve. Ajo u shpreh e vendosur se mësuesi ndihmës duhet bërë realitet në të gjitha shkollat.

Znj. Karabina vlerësoi bazën e të dhënave të krijuar nga projekti pranë Drejtorive Arsimore Rajonale, si një instrument shumë të dobishëm për të ndjekur ecurinë e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, Ministrja Karabina theksoi rëndësinë e trajnimit të mësuesve ndihmës. Ajo vijoi duke thënë se një vlerë e shtuar e këtij projekti ka qenë bashkëpunimi mes institucioneve të rëndësishme në vend si Universiteti i Elbasanit dhe Universiteti i Korcës, të cilat të mbështetura nga Universiteti i Bolonjës kanë mundur të rishikojnë programet e studimit në fushën e edukimit.

Ministrja falënderoi të gjitha palët për bashkëpunimin dhe u shpreh e bindur se vetëm duke punuar së bashku, arsimi gjithëpërfshirës mund të kthehet në një realitet të qëndrueshëm në Shqipëri dhe në Kosovë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, **z. Alush Istogu**, Sekretar Permanent i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) i Kosovës, falënderoi në mënyrë të veçantë, z. Christiano Agostini, si një mbështetës të madh të arsimit gjithëpërfshirës, theksoi se MASHT Kosovë ka krijuar infrastrukturë ligjore dhe infrastrukturë shkollore për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës. MASHT ka hartuar strategji për zhvillimin e arsimit në Kosovë, duke filluar me Strategjinë e Arsimit 2011-2016 dhe Strategjinë 2017-2021 që është miratuar së fundmi nga Qeveria. Save the

Children ka mbështetur MASHT në zbatimin e këtyre strategjive gjithëpërfshirëse në ngritjen e kapaciteteve, posaçërisht për ngritjen e kapaciteteve të divizionit (sektorit) përkatës në MASHT, sektor i cili punon drejtpërdrejt me monitorimin e politikave gjithëpërfshirëse me qendrat burimore dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Gjithashtu Save the Children ka zhvilluar fushata ndërgjegjësimi për mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës.

Më tej, Z. Istogu theksoi se MASHT Kosovë po rishikon formulën e financimit të arsimit gjithëpërfshirës dhe atë të qendrave burimore. SC ka ndihmuar për përcaktimin e kriterëve të formulës së financimit të arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë. MASHT i është mirënjohës Save the Children për mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë. Z. Istogu tha se priste që kjo konferencë të dilte me rekomandime me përfitim rajonal.

**Z. Nino Merola**, përfaqësuesi i Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim u shpreh se ishte i nderuar të ishte pjesë e kësaj konference për shkak të tematikës që kjo konferencë trajton. Arsimi gjithëpërfshirës i fëmijëve me AK na prek të gjithëve, siç tha znj. Ministre, por sidomos ekspertët në fushën e arsimit dhe organizatat e bashkëpunimit për zhvillim.

Në bashkëpunimin për zhvillim, ne Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim, tha z. Merola, fokusohemi kryesisht te zhvillimi ekonomik, në bashkëpunim me agjencitë e tjera. Këto organizata, vijoi ai, përpiqen të zhvillojnë indikatorët për zhvillimin ekonomik.

Por çka është e rëndësishme, është që të synohet një rritje ekonomike e balancuar, bazuar në kohezionin social, duke iu dhënë mundësi të gjithë grupeve të disavantazuara, përfshi fëmijët me AK. Kjo është shumë e rëndësishme, posaçërisht për Agjencinë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim, i cili ka një historik të gjatë në mbështetjen e rajonit, dhe ka mbështetur vendet e rajonit pikërisht për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës. Për Agjencinë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim, mbështetja e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me AK është prioritet strategjik, për të cilin kjo Agjenci ka realizuar edhe

fushata ndërgjegjësimi në strukturat e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Arsimi gjithëpërfshirës është një temë që Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim jo vetëm beson, por e nënvizon dhe e mbështet në mënyrë të veçantë. Kjo është arsyeja pse kjo konferencë përmbyllëse u konsiderua e rëndësishme nga Agjencia Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim. Z. Merola theksoi gjithashtu se, pavarësisht se ky aktivitet ishte konferenca përmbyllëse e projektit, mbështetja e qeverisë italiane për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me AK në arsim, nuk do të përfundonte këtu, por bazuar në rezultatet e këtij projekti, rezultate të cilat garantojnë vijimësinë falë bashkëpunimit me institucionet shqiptare, Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim do të vijonte me financimin e një projekti tjetër, i cili do të fokusohet te gjithëpërfshirja e fëmijëve në moshë parashkollore deri në 6 vjeç, me fokus të veçantë identifikimin e hershëm të fëmijëve me vështirësi zhvillimore në moshën 0-3 vjeç.

Në mbyllje të fjalës së tij, z. Merola u përqendrua në prezencën e organizatave joqeveritare italiane në rajon. Ai theksoi se këto organizata luajnë një rol të rëndësishëm, edhe pse këto organizata nuk kanë mbështetje financiare. Këto organizata bëjnë një punë të lavdërueshme, e cila vlerësohet nga qeveria italiane. Z. Merola tha se kjo ishte një nga karakteristikat e miqësisë italiane me Shqipërinë dhe Kosovën, sepse ishte në thelb të filozofisë së bashkëpunimit për zhvillim. Z. Merola i përgëzoi të gjitha këto organizata, por në radhë të parë Save the Children për një projekt shumë të suksesshëm. Ai falënderoi edhe institucionet shqiptare që me mbështetjen e tyre e bënë projektin një histori suksesi.

Seanca e mirëseardhjes u mbyll me fjalën e z. **Ahmet Kryeziu**, Drejtor i Save the Children në Kosovë

Z. Kryeziu përshëndeti Ministren e Arsimit dhe Sportit, znj. Mirela Karabina, z. Alush Istogu, z. Nino Merola, pjesëmarrësit dhe sidomos të gjithë kolegët e tij mysafir nga rajoni.

Z. Kryeziu u shpreh i lumtur që kjo konferencë ishte një platformë shumë e mirë për të

shkëmbyer punën e bërë në të dy shtetet për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në Kosovë, sipas z. Kryeziu, fëmijët me aftësi të kufizuara, janë një prej grupeve që përballen me stigmën, diskrimimin dhe mënjanimin në komunitetet e tyre. Z. Kryeziu tha se, sipas studimeve më të fundit, në Kosovë vlerësohet të jenë rreth 150.000 persona me aftësi të kufizuara, rreth gjysma e të cilëve mendohet të jenë fëmijë të moshës shkollore. Nga të dhënat ekzistuese, vetëm rreth 10% e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë mundësi të përfitojnë shërbime cilësore arsimore, shëndetësore dhe sociale. Për më tepër, sipas z. Kryeziu, ende mungon ofrimi i shërbimeve cilësore bazuar në nevojat individuale të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Pavarësisht se është bërë progres në zhvillimin e legjislacionit, ka ende pengesa në zbatim, sidomos në nivel komunal. Z. Kryeziu raportoi për një përvojë 13-vjeçare ndërhyrjesh në Kosovë, falë mbështetjes së veçantë të Save the Children Itali. Save the Children ka shënuar disa arritje të suksesshme në Kosovë, falë edhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile si Handikos. Save the Children Kosovë do të vazhdojë të përkrahë fëmijët me AK në Kosovë, duke bërë bashkë të gjithë aktorët me qëllim që fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e tjerë të ndihen pjesë e shoqërisë.

Konferenca vijoi me seancën plenare. Kjo seancë kishte për qëllim të prezantonte nismat e ndërmarra në rajon lidhur me arsimin gjithëpërfshirës dhe integrimin e fëmijëve me AK, si dhe praktika pozitive nga zbatues e përfitues të projektit. Dy prezantimet e para u përqendruan në politikat e ndjekura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës.

## Seancë plenare - Politikat dhe reformat në fushën e arsimit gjithëpërfshirës në rajon

**Znj. Rozalba Merdani**, shefe e Sektorit të Arsimit Bazë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) u përqendrua në prezantimin e kuadrit ligjor dhe të masave që MAS ka ndërmarrë dy vitet e fundit për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Së pari, zonja Merdani solli në vëmendje të pjesëmarrësve se bazë për zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës janë dispozitat e Ligjit "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton parimet bazë të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe garanton me dy nene të posaçme të drejtën e çdo fëmije, përfshi fëmijët me aftësi të kufizuara, për t'u arsimuar.

Sipas përcaktimeve të këtij ligji, në thelb të politikave dhe instrumenteve të zbatimit, përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme ka përparësi ndaj përfshirjes në institucionet arsimore të specializuara.

Në bazë të parimeve kryesore të Ligjit të Arsimit Parauniversitar, MAS është angazhuar në plotësimin e kuadrit ligjor me akte nënligjore. Dispozitat normative (DN) të Arsimit Parauniversitar, të miratuara në vitin 2013, përmbajnë një kapitull të veçantë dhe përcaktojnë strukturat e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim. Në DN përcaktohet qartë edhe roli i mësuesit ndihmës. Meqenëse pas miratimit të DN, ende kishte një vakum ligjor për angazhimin e mësuesve ndihmës, MAS u angazhua dhe nxori Udhëzimin nr. 38, datë 7.10.2014 "Për kriteret e mësuesit ndihmës në institucionet publike të arsimit parauniversitar" i cili i siguron çdo fëmije me AK në kopshte dhe në shkolla publike, krahas mësuesit të klasës apo lëndës, edhe mësuesin ndihmës. Në bazë të këtij Udhëzimi, nisi edhe emërimi i mësuesve ndihmës në shkolla. Këta mësues ishin kryesisht mësues të sistemit, të cilët kishin përvojë dhe trajnime në këtë fushë. Fillimisht u emëruan 65 mësues ndihmës. Deri në vitin 2017, numri i mësuesve ndihmës është pesëfishuar.

Sipas znj. Merdani, nga të dhënat administrative të MAS, për vitin shkollor 2016-2017 Në vitin shkollor 2016-2017, në shkolla të zakonshme u regjistruan rreth 3250 fëmijë me aftësi të kufizuara (AK), nga të cilët 114 me Sindromin Doun.

Nga këta fëmijë, 371 fëmijë me AK u regjistruan në arsimin parashkollor, 1663 në arsimin fillor 940 në arsimin e mesëm të ulët

dhe 278 në arsimin e mesëm të lartë.

Numri i nxënësve me AK është më i ulët në arsimin e mesëm të lartë, pasi edhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në këtë nivel arsimimi është më i vështirë.

Ndërsa në 10 institucionet arsimore të specializuara në: Tiranë, Vlorë, Shkodër, Fier, Berat, Durrës dhe Lezhë (përfshi institutet e fëmijëve që nuk dëgjojnë e shikojnë) u regjistruan rreth 590 nxënës. Këta nxënës, përveç kurrikulës së posaçme, nxënësit që frekuentojnë institucionet arsimore të specializuara, marrin shërbimet e nevojshme sipas llojit dhe shkallës së aftësisë kufizuar.

Disa nga arritjet dhe masat kryesore që MAS ka zbatuar dy vitet e fundit për shëndërrimin e gjithëpërfshirjes në realitet të arsimit shqiptar, janë:

- ▶ Ngritja dhe funksionimi në të gjitha DAR/ZA-të i Komisioneve Multidisiplinare të vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- ▶ Trajnimi i Komisioneve Multidisiplinare të DAR/ZA.
- ▶ Vendosja e 310 mësuesve ndihmës në shkolla publike të arsimit bazë për fëmijët me AK.
- ▶ Trajnimi i mësuesve ndihmës në DAR Durrës, Elbasan dhe Lezhë për arsimin e fëmijëve me problem shikimi.
- ▶ Hartimi i treguesve për mjedisin e të nxënësve gjithëpërfshirës dhe miqësor.
- ▶ Hartimi i profilit të mësuesit gjithëpërfshirës si udhëzues për zhvillimin profesional të mësuesve me qëllim krijimin e një mjedisi të nxënësi gjithëpërfshirës.

Sipas znj. Merdani, trajnimi i Komisioneve Multidisiplinare është thelbësor, pasi profesionalizmi i këtyre është përcaktues në vlerësimin dhe referimin e duhur të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Për MAS është e qartë se realizimi i arsimit

gjithëpërfshirës është një proces i gjatë e impenjativ, ndaj edhe synimet afatmesme në këtë drejtim do të jenë:

- ▶ Evidentimi dhe trajtimi i hershëm i aftësisë së kufizuar te fëmijët;
- ▶ Krijimi i mundësive infrastrukture për përfshirje në arsim të fëmijëve me AK.
- ▶ Ndërgjegjësimi i komunitetit të nxënësve dhe të prindërve për të drejtat e çdo fëmije për tu arsimuar në sistemin gjithëpërfshirës.
- ▶ Kualifikimi fillestar në universitete i mësuesve ndihmës si specialistë të arsimit gjithëpërfshirës mbetet një sfidë për MAS, ndaj kërkohet që bashkëpunimi i inciuar nga projekti ndërmjet universiteteve të Elbasanit, Korçës dhe Bolonjës të vijohet.
- ▶ Gjithashtu trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve ndihmës në sistem duhet të vijojë për të garantuar cilësinë e arsimit gjithëpërfshirës.
- ▶ Rritja e numrit të mësuesve ndihmës në shkolla gjithëpërfshirëse.
- ▶ Trajtimi sipas nevojës me PEI i fëmijëve me AK, të kthyer apo të trafikuar, duke filluar që nga arsimi parashkollor.
- ▶ Krijimi i mjediseve të përshtatshme sportive në shkolla dhe trajnimi i mësuesve të edukimit fizik për gjithëpërfshirjen.
- ▶ Integrimi në arsim dhe arsimim cilësor për viktimat e dhunës dhe fëmijët e emigrantëve të kthyer.
- ▶ Qëndrueshmëria, funksionimi i sistemit të ngritur konsiderohen si sfida kryesore në zbatim.

Në mbyllje të referatit të saj, znj. Merdani theksoi edhe një herë rëndësinë e përgatitjes fillestare të mësuesve për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve në sistem për pedagogjinë e specializuar, pajisjen me bazë

materiale e didaktike për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme, krijimin e një kulture që respekton standardet e integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe që shembin barrierat në kopshte dhe shkolla, si dhe kohezioni institucional, të cilat do të jenë sfidat kryesore, me zgjidhjen me sukses të të cilave do të matet edhe suksesi i politikave dhe i nismave ligjore për arsimin gjithëpërfshirës, modele këto të cilat i zhvilloi Save the Children për tre vite në Shqipëri dhe do vërehen nga MAS si praktika pozitive për të garantuar cilësinë e arsimit gjithëpërfshirës.

Znj. Merdani e përfundoi fjalën e saj duke thënë së bashkëpunimi ndërinstitucional është thelbësor për suksesin e gjithëpërfshirjen. Plani i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar ka krijuar mundësi të reja bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) dhe MAS në zbatimin e tij. Pilotimi i modelit bio-psiko-social në vlerësimin e aftësisë së kufizuar ka sjellë bashkë Komisionet Multidisiplinare të DAR Tiranë me njësitë administrative në Bashkinë e Tiranës.

Pas përvojës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në Shqipëri, znj. **Lulavere Behluli**, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të Kosovës u fokua gjithashtu në prezantimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në Republikën e Kosovës lidhur me zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe të formulës së re për financimin e arsimit gjithëpërfshirës, i cili garantohet nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe neni 47 i Kushtetutës së Kosovës.

Kosova ka një traditë të përfshirjes së nxënësve me AK, pasi shkollat speciale në Kosovë datojnë qysh në vitet 50 të shek.XX. Pas përfundimit të konfliktit në Kosovë, nisi puna për ngritjen e arsimit gjithëpërfshirës jo-diskriminues.

Hapat e parë për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt shkollor, në Kosovë kanë nisur në vitin 2001, ndërsa nga viti 2007 politikat arsimore janë orientuar drejt arsimit gjithëpërfshirës.



Duke nisur nga qeveria e deri në nivel lokal ka mekanizma të qartë për përfshirjen e personave me AK në jetën shoqërore.

Pjesë thelbësore e kuadrit rregullator janë:

- Ligji për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë – në process.
- Plani nacional për personat me aftësi të kufizuara 2016-2021.
- Këshilli nacional për personat me aftësi të kufizuara.
- Asociacioni për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Në kuadër të këtyre mekanizmave, MASHT i ka kushtuar vëmendje të veçantë hartimit të kuadrit ligjor, siç është Ligji për Arsimin Parauniversitar 2011 (nenet 39-42) si dhe Udhëzimet Administrative (akte nënligjore) në zbatim të këtij Ligji.

Përveç Ligjit për Arsimin Parauniversitar, janë edhe ligjet e tjera që rregullojnë të gjitha nivelet e sistemit arsimor që nga Ligji i Arsimit të Lartë, Ligji i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional, Ligji i Arsimit Parashkollor të cilat bazohen në parimet e arsimit gjithëpërfshirës.

Aktet nënligjore që zbatohen nga të gjitha institucionet në nivel qendror e komunal e bëjnë të zbatueshëm Ligjin në nivel praktik.

Ndërkaq, arsimi gjithëpërfshirës është bërë pjesë e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë PSAK 2016-2021 dhe e Planit strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar në Kosovë (2016 - 2020).

Më tej, zonja Behluli parashtroi një sërë dokumentesh, të cilat garantojnë arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë si:

- Korniza e Kurrikulës të Kosovës KKK, 2010
- Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (PSAK), 2016-2021
- Plan Strategjik për organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës të FNV në Arsimin

Parauniversitar në Kosovë ,2016-2020

- Standardet për shkollat mike për fëmij, 2012
- Plani Individual i Arsimit (PIA), 2010
- Programi “Mësimdhënia sipas fushave të aktiviteteve”
- Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet 201
- Indeksi për gjithëpërfshirje

Përveç këtyre strategjive, ka një sërë udhëzimesh administrative dhe dokumente ndihmëse që janë të nevojshme për mësuesit dhe zbatuesit e politikave të hartuara në nivel qendror.

Përveç kuadrit ligjor, sfida më e madhe për MASHT Kosovë mbetet financimi i arsimit gjithëpërfshirës. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara ka gjetur mbështetjen në mekanizmat e financimit të arsimit, nëpërmjet formulës së financimit për arsim në nivel qendror, formulës së financimit në nivel lokal dhe formulës së financimit për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, e cila është në proces. Reformimi i formulës për arsim do të sjellë rishikim edhe të formulës për arsim gjithëpërfshirës.

Aktualisht ka disa mekanizma që shkollat në autonominë e tyre të mund të shfrytëzojnë formulën e financimit për arsim në funksion të arsimit gjithëpërfshirës. Ka një linjë të qartë buxhetore nga MASHT për qendrat burimore.

Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara mundësohet në disa tipe institucionesh, ndër të cilat më të veçantat janë qendrat burimore. Fëmijët me aftësi të kufizuara mund të arsimohen gjithashtu në institucionet parashkollore, klasat e bashkëngjitura dhe klasat e rregullta dhe më pas të marrin shërbime mbështetëse në qendrat burimore.

Politikat decentralizuese kanë sjellë një ndarje të përgjegjësive institucionale ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), nëpërmjet Divizionit për Arsimin e Nxënësve me Nevoja të

Veçanta dhe Komunave (pushtetit vendor), të cilat kanë në strukturat e tyre një zyrar përgjegjës për arsim gjithëpërfshirës dhe ekipet vlerësuese pedagogjike.

Aktualisht një divizion i posaçëm funksionon në MASHT. Ky divizion (sektor) bashkëpunon ngushtë me koordinatorët në nivelin e komunave. Megjithatë ende ka shumë për të përmirësuar në drejtim të bashkëpunimit dhe koordinimit. Në shkollat e rregullta janë ngritur njësitë e mbështetjes së gjithëpërfshirjes.

Politikat për decentralizimin e arsimit janë reflektuar edhe në planifikimin dhe operacionalizimin e buxheteve të dedikuara edhe për arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Aktualisht në Kosovë funksionojnë gjithsej 7 qendra burimore, të cilat ofrojnë mbështetje për arsim për nxënësit me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta, nëpërmjet kurrikulave të përshtatutra, planit individual të arsimit dhe programit “Mësimdhënie me fusha të aktiviteteve”. Për më tepër, qendrat burimore shërbejnë si qendra kërkimore, si dhe ofrojnë trajnime të licencuara (16 programe të licencuara) për mësuesit ndihmës në shkollat e zakonshme. Qendrat burimore dokumentojnë praktikat pozitive dhe ofrojnë shërbim në familje.

MASHT Kosovë ka nxjerrë një Udhëzim të posaçëm në vitin 2013 për shkrirjen e klasave të bashkëngjitura, gjë që ka sjellë rënien e numrit të klasave të bashkëngjitura në 21 me objektiv mbylljen përfundimisht të këtyre klasave në shkollat e rregullta.

Në vitin 2016, MASHT hartoi një dokument të quajtur “Mësimdhënia sipas fushave aktiviteteve”, dokument i cili iu vjen në ndihmë, sidomos, nxënësve me dëmtime të shumëfishta.

Çdo qendër burimore ka nga tri programe trajnimi sipas llojeve të aftësisë së kufizuar që kanë fëmijët. Ndaj qendra burimore ofron programe trajnimi për të gjitha shkollat e vendit lidhur me një aftësi të kufizuar specifike. Qendrat burimore identifikojnë mësuesit dhe shkollat model dhe sivjet do

të botohet një përmbledhje të shkollave dhe modeleve pozitive.

Mekanizëm tjetër që janë integruar, janë disa profile të reja si:

- Mësuesi udhëtues
- Mësuesi mbështetës
- Asistenti i fëmijëve/nxënësve
- Asistenti/instruktori për gjuhën e shenjave

Këto profile edhe pse janë parashikuar në kuadrin ligjor, janë të vështira për t'u gjendur, sepse jo të gjithë mësuesit janë në gjendje të japin shërbimet e nevojshme, ndaj prioritet për Kosovën është trajnimi i mësuesve (bazë) dhe i mësuesve mbështetës.

Kosova shënon një sërë praktikash pozitive, të cilat mbështesin arsimin gjithëpërfshirës si:

- Programi master - 15 student të diplomuar\ **Universiteti i Juvaskulas-Finlandë**
- Niveli i 5-të për asistent për nxënësit me aftësi të kufizuar. Këtë vit do të hapet një profil i ri “**Asistent për fëmijë me aftësi të kufizuara**” në nivelin e 5-të (arsim pas të mesmes) me mbështetjen e Lux Development. Ky profil është hartuar në bashkëpunim me **Institutin Pearson**. Ky profil do të ofrohet për disa vite, derisa të mbulohen nevojat për këta lloj specialistësh. **Instituti Pearson/ diploma BTEC**.
- Kapacitetet e ngritura për ofrimin e shkrim leximit në Brail në gjithë vendin
- Programi 3-vjeçar për asistent dhe instuktur të gjuhës së shenjave
- Trajnimi i 7400 mësimdhënësve dhe edukatorëve përfshi edhe trajnimet e integruara në trajnimet për kurrikulat;
- Programi i zhvillimit profesional 2-vjeçar në fushën e arsimit gjithëpërfshirës 126 persona të certifikuar\ **Universiteti i Juvaskulas-Finlandë**

- Hartimi i standardeve të profesionit për 3 profile të arsimit profesional i bazuar në 3 nivele.

Të rëndësishme për MASHT Kosovë janë edhe studimet dhe kërkimet e ndryshme. Këto studime ndihmojnë shumë për të matur impaktin e politikave të zbatimit të tyre. Edhe në rastet kur rezultatet e studimeve nuk janë pozitive, ato janë ndihmë e veçantë për institucionet politikëbërëse në Kosovë.

Përpos projekteve të tjera, të cilat mbështeten kryesisht në kërkim dhe mbështetje burimore për qendrat burimore, mbështetje për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë është ofruar nga Save the Children, veçanërisht në: hartimin e politikave dhe ngritjen e kapaciteteve në nivel qendror dhe komunal (pushtetit vendor), në hartimin e indeksit për gjithëpërfshirje prej vitit 2005, në investime në institucionet parashkollore gjithëpërfshirëse. Indeksi i gjithëpërfshirjes është një dokument shumë i rëndësishëm, i cili i ka ndihmuar jashtëzakonisht shkollat në përmisimin e polotikave dhe praktikave të tyre gjithëpërfshirëse.

Në nivel shkolle, Save the Children ka mbështetur zbatimin e modeleve gjithëpërfshirëse, punësimin e mësuesve mbështetës, ngritje të kapaciteteve të stafit dhe drejtuesve, si dhe në pajisjen e shkollave me materiale.

Bashkëpunimi me Save the Children vijon për hartimin e dokumentit vlerësues të KNF (ICF).

Gjithashtu hartimi i kritereve për fëmijët me aftësi të kufizuara jashtë shkollës mbetet sfida kryesore dhe këtu bashkëpunimi me Save the Children ka qenë shumë i rëndësishëm.

Hartimi i parametrave të financimit për nxënësit me aftësi të kufizuara, studime të ndryshme, hartimi i treguesve për nxënësit me nevoja të veçanta në shkollë e jashtë saj, hartimi i dokumenteve mbështetëse për shkollat dhe komunat, si dhe fushatat e ndërgjegjësimit të organizuara në bashkëpunim me Save the Children kanë kontribuar në konsolidimin e këtij procesi afatgjatë, i cili kërkon ndryshim të

vazhdueshëm të sistemit arsimor, të shkollës dhe mësimdhënësve.

Znj. Behluli qëllimisht nuk prezantoi shifra për nxënësit me AK në Kosovë, pasi këta të dhëna nuk janë të ndara për nxënësit me AK dhe nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe të dhënat që vijnë nga shkollat nuk janë të qarta.

Pavarësisht nga të gjitha arritjet, arsimit gjithëpërfshirës është sfidë më vete. Sfidë mbetet zhvillimi profesional i mësuesve, cilësia e mësimdhënies për nxënësit me AK në shkolla dhe ofrimi i shërbimeve qysh në fëmijërinë e hershme. Buxheti dhe mungesa e shërbimeve mbështetëse mbeten sfida, pasi aftësia e kufizuar nuk mund të adresohet vetëm në një këndvështrim. Shërbimet rehabilituese janë thelbësore për personat me aftësi të kufizuara. Në Kosovë ka mungesë literature në gjuhën shqipe për aftësinë e kufizuar.

Në fund të prezantimit të saj, duke falënderuar organizatorët SC në Kosovë dhe Shqipëri për mundësinë e ndarjes së përvojave të Kosovës, znj. Behluli theksoi se gjithëpërfshirja është një proces i cili nuk ndalet dhe që kërkon vazhdimisht përpjekje e që nuk mund të realizohet në një kohë afatshkurtër, pasi gjithëpërfshirja kërkon ndryshim të vazhdueshëm të sistemit arsimor.

Pas prezantimit të politikave të ndërmarra nga qeveritë e dy vendeve, seanca plenare vijoi me prezantimin e praktikave pozitive nga vendet pjesëmarrëse.

## Seance plenare - Praktikat më të mira në realizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në rajon

*Praktikat më të mira dhe partneriteti me shoqërinë civile në fushën e Arsimit Gjithëpërfshirës në Kosovë - Rudina ADEMI SHALA – Save the Children në Kosovë & Afrim MALIQI - Handikos*

Arsimi gjithëpërfshirës është një ndër prioritetet e Save the Children në Kosovë. SC ka qenë ndër partnerët kryesorë të institucioneve të Kosovës në zbatimin

e modelit të arsimit gjithëpërfshirës. Në prezantimin e tyre, znj. Rudina Ademi Shala (Save the Children në Kosovë) dhe z. Afrim Maliqi (Handikos) prezantuan praktikat më të mira të punës së Save the Children për mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës në bashkëpunim e partneritet të ngushtë me shoqërinë civile. Më konkretisht, programi i Save the Children për arsimin gjithëpërfshirës realizohet në 14 komuna në partneritet me 10 organizata të shoqërisë civile. Synimi kryesor i këtij programi është që çdo fëmijë të gëzojë të drejtën për arsim cilësor gjithëpërfshirës si parakusht për mirëqenie e sukses në jetë. Fëmijët nga grupet e privuara, përfshirë këtu fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga familjet e pakicave kombëtare dhe fëmijët që jetojnë në varfëri, duhet të kenë akses e të përfitojnë nga arsimi formal dhe jo-formal.

Qasja e SC për arsimin gjithëpërfshirës bazohet në tri parime kryesore:

1. Përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve nga grupet e privuara në arsim cilësor e gjithëpërfshirës.
2. Rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë.
3. Advokimin për rritjen e financimit të arsimit gjithëpërfshirës.

Kjo qasje mbështetet nga partnerët kryesorë të këtij programi, si: MASHT, organizatat e shoqërisë civile, Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Bolonjës.

Në sajë të një ndërhyrjeje shumëplanëshe, është arritur të regjistronen rreth 834 nxënës me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor, parafillor dhe fillor të rregullt (të zakonshëm). Gjithashtu janë përfshirë 17 mësues ndihmës në buxhetin komunal dhe është hartuar përkrahimi i punës së këtyre mësuesve, janë trajnuar 784 mësues me metodologjinë e gjithëpërfshirjes në 14 programe trajnimi të akredituara. Falë mbështetjes së SC është mundur zbatimi i indeksit për gjithëpërfshirje si dhe është akredituar programi i studimeve master në edukim gjithëpërfshirës, i cili ofrohet nga Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me

Universitetin e Bolonjës.

Mbështetja për ngritjen e ekipeve vlerësuese në komuna, për hartimin e dokumenteve politike e për financimin e arsimit gjithëpërfshirës, të cilat u përmendën edhe nga përfaqësuesja e MASHT Kosovë, znj. Lulavere Behluli, kanë qenë gjithashtu arritje të rëndësishme të ndërhyrjeve për arsimin gjithëpërfshirës nga Save the Children Kosovë.

Projektet e realizuara nga Save the Children Kosovë për gjithëpërfshirjen, në mënyrë të vecantë, projekti i mbështetur nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim është nderuar me një cmim ndërkombëtar nga "Zero Projekt Austri".

Për të arritur rezultatet e mësipërme është dashur një punë disaveçare, e cila është mbështetur edhe nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese prej vitit 2011 deri në vitin 2015. Pjesë e rëndësishme e fushatës ka qenë edhe artistja ambasadore e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Save the Children Kosovë ka ngritur, ndër të tjera, një partneritet të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile në Kosovë bazuar në vlera dhe fuqizim, transparencë dhe llogaridhënie dhe përfitime të përbashkëta. Save the Children dhe Handikos kanë punuar për rreth 20 vite për të kontribuar në advokim dhe adresimin dhe zvogëlimin e barrierave për akses në arsim cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe për të rritur pjesëmarrjen e tyre në jetën shoqërore. Ne angazhohemi në ofrimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve mbështetëse për fëmijët me AK dhe familjet e tyre. Nga disa vlerësime ndërkombëtare në Kosovë mund të ketë rreth 150,000 persona me aftësi të kufizuara në Kosovë, rreth 50% e tyre konsiderohet të jenë fëmijë të moshës shkollore, ndërsa përfshirja e tyre në sistemin shkollor varion nga 5,000 deri në 5,500 (6.6 – 7.3%).

Pavarësisht nga këto praktika pozitive, situata e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë kushtëzohet nga mungesa e planifikimit strategjik, çka përbën rrezik për qëndrueshmërinë, nga një varësi e madhe

nga komuniteti i donatorëve, nga mungesa e njohurive për të drejtat e fëmijëve dhe nga niveli i ulët i financimeve nga buxheti i shtetit për shoqërinë civile.

Megjithatë, Save the Children në Kosovë dhe Handikos adresojnë së bashku pabarazinë dhe diskriminimin. Ata përfshijnë aktorë të ndryshëm, të rritur e fëmijë, për të ndryshuar qëndrime e për të iniciuar ndryshime në shoqëri. Kjo arrihet edhe falë njohjes që organizatat e shoqërisë civile kanë dhe faktit se ato vijnë dhe krijohen nga komuniteti dhe sjellin në këtë mënyrë, nuancat kulturore e nevojat e komunitetit.

Ndryshim që mund të sjellin organizatat e shoqërisë civile është identifikimi i pabarazive në integrim dhe përfshirja e fëmijëve dhe të rriturve për të zvogëluar barrierat në gjithëpërfshirje. Organizatat e shoqërisë civile vijnë nga nevojat e komunitetit dhe të grupeve më të rrezikuara e të marginalizuara. Duke u mbështetur te mjetet financiare, një studim i kryer nga Handikos, nxori në pah se numri i personave me AK që ndjekin studimet e larta, është shumë i vogël dhe barrierat kryesore lidhen me mungesën e lehtësirave për udhëtim, dhe të asistentit social. Kjo vjen pasi kërkohet një qasje ndërsektoriale dhe jo vetëm nga Ministria e Arsimit.

*Arritjet nga bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Bolonjës, Elbasanit dhe Korçës në reformimin e programeve kurrikulare në departamentet e edukimit në Universitetin e Korçës dhe Elbasanit*

Universitetet e Korçës, Elbasanit dhe Bolonjës, konkretisht departamentet ose fakultetet përgjegjëse për programet e mësuesisë, prezantuan përvojën e tyre trevjeçarë në kuadër të projektit “Arsimi gjithëpërfshirës i fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri”. Në emër të tri universiteteve pjesëmarrëse prezantoi **z. Arjan Kamburi**, pedagog në Universitetin “Fan Noli” Korçë.

Ky projekt i përbashkët ka arritur të mbështesë zhvillime të rëndësishme si:

- Risi në kurrikulat universitare lidhur me arsimin gjithëpërfshirës, posaçërisht

në programet e mësuesisë (programet e kualifikimit të mësuesve të rinj në Universitetin e Korçës dhe të Elbasanit, si edhe në trajnimin e stafit akademik me kohë të plotë në këto universitete).

- Rishikimi i programeve të lëndëve të veçanta, në teori dhe praktikë me fokus tek arsimit gjithëpërfshirës;
- Integrimi i metodave moderne të mësimdhënies, me qasje bashkëpunuese dhe aktive, me qëllim inkurajimin e mbështetjen e studentëve për t'u angazhuar në kërkim në fushën e arsimit gjithëpërfshirës;
- Promovimi i gjithëpërfshirjes në shkollat e zakonshme nëpërmjet mësuesve profesionistë e kompetentë;
- Organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare për të kryer krahasime në fushën kërkimore, për të ofruar mundësi shkëmbimi ndërmjet projekteve të ndryshme me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve;
- Promovimi i proceseve kulturore, të cilat mbështesin e rrisin kuptimin për funksionin social e gjithëpërfshirës të shkollës;
- Promovimi i konceptit të hapësirës dhe shoqërisë si vende ku jetojnë diferencat e gjithëpërfshirja;
- Hartimi i programit të studimit për fëmijërinë e hershme, i cili është në proces akreditimi
- Gjithashtu hartimi i një draft-programi për kujdestar të fëmijëve nga Universiteti i Elbasanit
- Qendra e Ekselencës e Universitetit të Korçës në bashkëpunim me MEDPAK ka organizuar trajnimin e 300 mësuesve ndihmës në dy module të edukimit gjithëpërfshirës.
- Zhvillimi i materialeve burimore për studentët dhe për zhvillimin e vazhduar profesional të mësuesve ndihmës.

Ndërkohë ekspertja nga Universiteti i Bolonjës - Itali znj. **Federica Zanetti**, theksoi se bashkëpunimi me universitetet shqiptare në këtë projekt 3-vjeçar ishte shumë i rëndësishëm. Ky bashkëpunim ishte i suksesshëm pasi solli ndërhyrje në katër fusha të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën: a) trajnimin për mësuesit në shërbim; b) zhvillimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në strategjitë e mësidhënies dhe mësimnxënies; c) aktivizimi i proceseve të ndryshimit në krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse dhe d) zhvillimi i kërkimit, shkëmbimi dhe ndërkombëtarizimi.

Bashkëpunimi në këtë projekt kishte si qëllim promovimin e praktikave më të mira dhe inovative të universitetit si qendër komunitare, e cila ofron mundësi trajnimi dhe shërben si mjedis, i cili krijon një dimension bashkëpunimi, bashkekzistence dhe zhvillimi. Në fund të prezantimit të saj, përfaqësuesja e universitetit të Bolonjës, ndau me të pranishmit shembullin frymëzues të një djali autik (Mr.Be Free), i cili frymëzoi komunitetin e tij për t'i dhënë një kuptim të thellë arsimit gjithëpërfshirës: [https://www.youtube.com/watch?v=LcG7\\_d466gs](https://www.youtube.com/watch?v=LcG7_d466gs)

*Vlerësimi dhe identifikimi i nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë. Arritjet dhe Vështirësitë. – znj. **Milita TURHANI**, Kryetare e Komisionit Multidisiplinar në Drejtorinë Arsimore Rajonale Elbasan*

Në kuadër të prezantimit të praktikave pozitive, znj Milita Turhani, kryetare e Komisionit Multidisiplinar në Drejtorinë Arsimore Rajonale Elbasan, prezantoi punën e këtij komisioni për vlerësimin dhe identifikimin e nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë në qarkun e Elbasanit, model i cili është zhvilluar paralelisht edhe në 6 rajonet e tjera në Shqipëri: Korçë, Gjirokastër, Vlorë, Durrës, Burrel dhe Peshkopi.

Ky komision u ngrit në vitin 2014 bazuar në dispozitat e Ligjit nr.69/2012 “Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe Dispozitat Normative 2013 si dhe Udhëzimin përkatës të MAS.

Në komision ishin pjesëmarrës aktivë të gjithë anëtarët e komisionit (mjeku peditër neurolog, psikologu, punonjësi social, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar dhe drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social).

Fokusi i punës së këtij komisioni ishte vlerësimi mësimor bazuar në vlerësimin e:

- Funksioneve konjitive
- Funksionimit social
- Marrëdhëniet ndërpersonale: marrëdhëniet me prindërit, marrëdhëniet me mësuesit, marrëdhëniet me moshatarët
- Zhvillimit motorik fin dhe global
- Zhvillimit psiko-emocional

Në përmbushje të funksioneve të tij, Komisioni Multidisiplinar për Vlerësimin e fëmijëve me AK në DAR Elbasan hartoi një plan ndërhyrjeje të bazuar në disa problematika emergjente, si:

1. Identifikimi nga shkollat i nxënësve me aftësi të kufizuara (me raport) dhe raportimi i tyre në DAR Elbasan;
2. Krijimi i bazës së të dhënave (database) të nxënësve me aftësi të kufizuara të vlerësuara sipas DSM 5, të cilët përfitonin KMCAP për frekuentimin e shkollave normale në të gjithë qarkun e Elbasanit, sipas listave të përcjella nga drejtuesit e shkollave;
3. Vlerësimi në terren i nxënësve me aftësi të kufizuara;
4. Përcaktimi i orëve të punës për mësuesit mbështetës sipas vështirësisë së nxënësve me aftësi të kufizuara në zbatim të Udhëzimit nr. 38, datë 7.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara”;
5. Vendosja e 9 (nëntë) mësuesve ndihmës në periudhën 2014-2015 në shkollat ku situata ishte emergjente;

6. Identifikimi i nxënësve me vështirësi në të nxënë, të cilët nuk posedonin një raport vlerësimi nga KMCAP.

Gjatë tre viteve, Komisioni ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh të ofruara nga projekti me tematikat e mëposhtme:

- Identifikimi i nevojave dhe burimeve të mbështetjes për një shkollë gjithëpërfshirëse, si dhe roli i mjedisit social dhe efekti i tij në të nxënëit e fëmijës me aftësi të kufizuara.
- Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit të Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit – për fëmijë dhe të rinj ( ICF).
- Përdorimi i teknikave të përforcimit pozitiv si mjet për motivimin e nxënësve me AK.
- Hartimi dhe zbatimi i Planeve Edukative Individuale.
- Të kuptuarit dhe manaxhimi i sjelljeve të fëmijëve me autizëm në klasat gjithëpërfshirëse.
- Mësimdhënia për nxënësit me vështirësi në të nxënë.

Anëtarët e komisionit kanë marrë pjesë dhe në takime apo tryeza teknike për aftësinë e kufizuar, të organizuara nga projekti.

Më konkretisht, puna e komisionit ka konsistuar në:

- Vlerësimin në terren të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Vlerësimin e fëmijëve pa raport dhe të fëmijëve me vështirësi në të nxënë
- Vlerësimin e fëmijëve sipas KNF – FR (ICF)
- Vlerësimin e nxënësve me autizëm
- Vlerësimin dhe diagnostifikimin e nxënësve deri në KMCAP, sipas kërkesës së komisionit të shkollës për nxënësit me aftësi të kufizuara

Komisioni Multidisiplinar i Vlerësimit në DAR Elbasan ka krijuar një protokoll të qartë të menaxhimit të rasteve, i cili përbëhet nga:

- ✓ Diagnoza e fëmijës
- ✓ Takimi me prindin dhe mësuesen e lëndës
- ✓ Marrja e informacionit nga mësuesja mbështetëse mbi pikat e forta dhe të dobëta të nxënësit/nxënësës
- ✓ Takimi me nxënësin dhe vëzhgimi gjatë procesit mësimor
- ✓ Mbledhja e komisionit të shkollës me psikologe dhe prindin
- ✓ Vlerësimi i gjendjes së fëmijës
- ✓ Analiza dhe interpretimi i të dhënave të grumbulluara
- ✓ Përcaktimi i synimeve vjetore të punës me këtë fëmijë, i objektivave afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtër
- ✓ Përparimi i pritshëm i fëmijës
- ✓ Ndërhyrjet, shërbime dhe trajtime speciale, për të cilat ka nevojë fëmija
- ✓ Hartimi i një programi individual me këtë fëmijë
- ✓ Çfarë do të mësojë fëmija nga kurrikula e lëndës
- ✓ Në ç'mënyrë do të përfitojë dhe zhvilloj potencialin e tij maksimal
- ✓ Plotesimi i listës së kontrollit dhe skedes amnestike
- ✓ Dhënia e rekomandimeve nga komisioni multidisiplinar

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme ka ardhur në rritje për shkak të ndërgjegjësimit të prindërve, vënies në dispozicion të mësuesit ndihmës, trajnimi i bashkëmohatarëve për pranimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat normale.

*Disa nga arritjet kryesore të punës së këtij*

### *Komisioni kanë qenë:*

- Vlerësimi i 147 nxënësve me aftësi të kufizuar
- Vlerësimin i 12 fëmijëve me aftësi të kufizuar me instrumentin e KNF-FR (ICF) (2015 – 2016)
- Vlerësimi i fëmijëve me vështirësi në të nxënë në bazë të kërkesave specifike të kërkuar nga komisionet e vlerësimit në bazë shkolle
- Emërimi i 29 mësuesve ndihmës, proces i cili vazhdon për të përmbushur nevojat e shkollave me numër në rritje të nxënësve me aftësi të kufizuara
- Trajnimet dhe takimet e shpeshta me mësueset ndihmëse organizuar nga komisioni multidisiplinar – DAR në bashkëpunim me shkollën “Zëra Jete” dhe MEDPAK.
- Janë vlerësuar gjithsej 224 nxënës sipas KNF.

Plani i punës së këtij Komisioni për periudhën 2017-2018 do të fokusohet në vendosjen e mësuesve ndihmës, në shkollat ku mësuesi ndihmës mungon, në ofrimin e trajnimeve për mësuesit ndihmës, vlerësimin e fëmijëve pa raport, vlerësimin mjeko-ligjor dhe në dhënien e rekomandimeve për shkollat.

Znj. Turhani falënderoi MAS, DAR Elbasan, Universitetin e Elbasanit dhe Korçës për ndihmën me manualet, falënderoi Universitetin e Bolonjës për trajnimet, të gjithë prindërit që mbështesin punën e Komisionit Multidisiplinar, falënderoi gjithashtu në mënyrë të vecantë Save the Children dhe MEDPAK, pa mbështetjen e të cilëve këto praktika kaq pozitive do të ishin pa dyshim shumë vështirë për tu realizuar.

Në vijim të prezantimit të përvojës nga puna me Komisionet Multidisiplinare të Vlerësimit, z. **Krzysztof SZADEJKO**, eksperiti nga Universiteti i Modenës në Itali, solli në vëmendje të konferencës punën e bërë për trajnimin e Komisioneve Multidisiplinare për Klasifikimin Ndërkombëtar të Aftësisë

Kufizuar dhe Shëndetit (KNF – FR) ICF. Ky trajnim u zhvillua në zbatim të politikave arsimore të shtetit shqiptar, të cilat po orientohen gjithnjë e më tepër drejt filozofisë së arsimit gjithëpërfshirës bazuar në modelin bio-psiko-social.

Kuadri ligjor në Shqipëri kërkon që Komisionet Multidisiplinare t'i referohen instrumentit ICF (OBSh 2001) në vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara.

KNF (ICF) është një instrument i njohur për të gjithë ekspertët, i cili nisi të integrohej në Shqipëri, duke filluar nga viti 2015. Nëpërmjet këtij projekti të mbështetur nga Save the Children në Shqipëri dhe shoqatës MEDPAK u njohën dhe u trajnuan me këtë instrument Komisionet Multidisiplinare në: Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Vlorë, Korçë, Burrel, Peshkopi dhe Tiranë.

Gjatë trajnimeve u identifikuan vështirësitë që Komisionet Multidisiplinare kanë në bashkëpunimin me mjekët e familjes, çka sjell nevojën e dmospodoshme të përfshirjes në trajnime edhe të mjekëve të familjes.

Numri i Komisioneve Multidisiplinare është shumë i vogël në raport në numrin shumë të madh të fëmijëve me AK për t'u vlerësuar.

Një tjetër problematikë është pamundësia e Komisioneve Multidisiplinare për të adresuar nevojat e qarkut që mbulojnë. Gjithashtu kërkohet ngritja e rrjeteve efektive të komunikimit e bashkëpunimit ndërmjet Komisioneve Multidisiplinare, universiteteve dhe ministrive përgjegjëse (për arsimin dhe shëndetësinë).

Sipas z. Szadejko, KNF ka disa të meta, sepse bazohet në modelin bio-psiko-social, model i cila duhet të zgjerohet me disa aspekte cilësore, sic është vëzhgimi. Duhet shtuar edhe dimensionet e tjera, për ta plotësuar këtë model. P.sh. si ndihen fëmijët në karrige me rrota? Çfarë do të thotë për ta të jenë në karrige me rrota? Pa dyshim që modeli bio-psiko-social bën vlerësime e matje të sakta, por profesionistët duhet të jenë mendjehapur për të përfshirë disa instrumente vëzhgimi nga këndvështrimi pedagogjik i edukimit të fëmijëve me AK.



*Bashkëpunimi midis stafit menaxhues të shkollës dhe atij pedagogjik për të siguruar arsimin cilësor të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë.*

Shembull i bashkëpunimit të suksesshëm ndërmjet stafit drejtues dhe mësuesve për të garantuar arsim cilësor gjithëpërfshirës për nxënësit me aftësi të kufizuara u paraqit nga përfaqësuesit e shkollës “Urani Rumbo” Gjirokastër, **znj. Elena Meçoni**, nëndrejtoreshë në shkollën 9-vjeçare “Urani Rumbo” dhe **znj. Aida Sotiri**, mësuese parashkollori në shkollën 9-vjeçare “Urani Rumbo”.

Në këtë shkollë mësojnë 420 nxënës ku përfshihen klasa parapërgatitore, klasa të arsimit fillor, të arsimit të mesëm të ulët dhe të shansit të dytë, ku përfshihen nxënës jetimë nga shtëpia “Vatra e ngrohtë”, nxënës nga komuniteti egjiptian dhe nxënës me aftësi të kufizuara.

Stafi i kësaj shkolle përbëhet nga 27 mësues, të cilët punojnë fort për arsimin cilësor të nxënësve të tyre .

“Urani Rumbo” është një shkollë me tradita e shpeshherë e vlerësuar maksimalisht nga Institucionet përkatëse të Arsimit.

Angazhimi i kësaj shkolle me arsimin gjithëpërfshirës nisi në vitin 2006 përsëri me një projekt të Save the Children në Shqipëri e cila implementoj në atë periudhë “Arsimi gjithëpërfshirës kërkesë e mijëvjeçarit të ri”. Në këtë vit (2006), kjo shkollë pranon e regjistron nxënësin e parë më aftësi të kufizuara, ndërsa aktualisht në vitin 2017 janë të regjistruar 8 nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Shkolla është partnere e besueshme, prej vitit 2006 e deri në 2017 e Save the Children dhe MEDPAK në projektet për të arsimuar me cilësi fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

“Urani Rumbo” është një shkollë mikpritëse për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, është një shkollë që udhëhiqet nga parimi “Barazi në të drejta dhe akses për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim”. Ajo me plotë kuptimin e fjalës është shkollë model e arsimit gjithëpërfshirës.

Disa nga masat dhe mekanizmat e zbatuara nga kjo shkollë ishin:

- Evidentimi i aftësive akademike, aftësive sociale dhe zbatimi i ligjit të APU për fëmijët me nevojave të veçanta në edukim.
- Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta, bazuar në PEI të ndërtuar nga komisioni në bazë shkolle dhe zbatuar nga mësuesi i klasës dhe mësuesi ndihmës.
- Bashkëpunimi në grup (komisioni në bazë shkolle) duke evidentuar aftësitë, potencialet e fëmijëve me nevoja të vecanta.
- Trajnimi i mësuesve - nxënësve - prindërve të shkollës në funksion të njohjes së aftësisë së kufizuar dhe nevoja të veçanta që fëmijët me aftësi të kufizuara kanë , ndryshimit të qëndrimit ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Implementimi i Indeksit të Gjithëpërfshirjes në shkollë për përmisimin e shkollës drejtë një shkolle gjithëpërfshirëse.
- Shkëmbim eksperience dhe binjakëzimi i shkollës sonë me shkollën “Emin Duraku ” në Prishtinë/Kosovë, shkollë e cila është e përfshirë në projektet e Arsimit Gjithëpërfshirës.

Faktorë kyçë për suksesin e ndërhyrjeve për arsim gjithëpërfshirës në këtë shkollë kanë qenë bashkëpunimi me bordin e shkollës, krijimi i mundësive për praktikim të aftësive për jetën dhe aftësive për punë, ndihma vullnetare e prindërve, mbështetja nga SC për zhvillimin profesional të stafit, bashkërendimi i programit dhe i punës ndërmjet mësuesit të lëndës dhe mësuesit ndihmës.

Shkolla ka informuar prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara mbi kuadrin ligjor për arsimin gjithëpërfshirës. Ndërgjegjësimi i bashkëmoshatarëve është realizuar në sajë të masave dhe aktiviteteve të ndërmarra nga qeveria e shkollës.

Kryetari i Bordit të shkollës ka mbështetur zhvillimin e konkurseve artistike nga fëmijët me AK.

Përkushtimi ka qenë filozofia e suksesit e shkollës “Urani Rumbo” në jetësimin e prioriteteve të arsimit.

Duke prezantuar shembullin e modelit social dhe përpjekjet e saj për të krijuar një model suksesti të një klase “jo-normale” në një shkollë normale, mësuesja e shkollës “Urani Rumbo”, Aida Sotiri, vlerësoi mbështetjen e ofruar nga Save the Children në Shqipëri dhe MEDPAK.

*Krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse: Bashkëpunimi midis fëmijëve dhe bashkëmoshatarëve të tyre në shkollë dhe komunitet*

Në vazhdim, përfaqësuesi i qeverisë së nxënësve **Armando Kallavaraj**, të shkollës “Demir Gashi” në Peshkopi, shkollë e mbështetur nga projekti ndau me pjesëmarrësit e konferencës përvojën e tij me bashkëmoshatarët me aftësi të kufizuara në këtë shkollë. Ai theksoi se projekti i zbatuar në këtë shkollë nga SC nëpërmjet MEDPAK i kishte dhënë mundësinë të ndryshonte paragjykimet për nxënësit me aftësi të kufizuara, i kishte dhënë mundësinë të kuptonte atij dhe gjithë bashkëmoshatarëve të tij se nxënësit me aftësi të kufizuara gëzojnë të njëjtat të drejta, jo vetëm për të frekuentuar shkollën, por edhe për të përvetësuar programin mësimor në bazë të aftësive që kanë.

Përfituese e mbështetjes së ofruar nga projekti i Save the Children për arsimin gjithëpërfshirës në Peshkopi ishte edhe Marjeta dhe vajza e saj me aftësi të kufizuara, Jusra, e cila pas shumë vështirësish gjeti mjedisin e duhur në shkollën “Demir Gashi” në Peshkopi.

Nëna e saj, Marjeta, tregon se si së pari arriti të pranonte faktin se vajza e saj ishte me aftësi të kufizuara. Në klasën e parë, Jusra u gjend në një shkollë, e cila nuk ishte e përgatitur për ta pranuar aftësinë e kufizuar. Kjo fazë ishte shumë e vështirë për Jusrën dhe familjen e saj.

Pasi nuk gjeti mjedisin e duhur, nëna e Jusrës u konsultua me koordinatoren e shkollës tjetër, e cila ishte edhe punonjëse e MEDPAK, e cila e informoi mbi mundësinë që ofronte kjo shkollë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Tashmë ajo shprehet e lehtësuar dhe e mbështetur nga stafi mësimor i shkollës “Demir Gashi”, të cilët bënë të mundur që Jusra të punonte me një plan edukimi të individualizuar, me të cilin edhe nëna e saj punonte me të në shtëpi. Angazhimi për arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollën “Demir Gashi”, ky model arsimimi i cili u jep mundësinë fëmijëve si Jusra të shfaqin cilësitë e tyre si pjesë e vyer e shoqërisë, u vlerësua jashtëmase nga Marjeta.

E rëndësishme ishte edhe trajnimi që vetë prindërit e vajzës me aftësi të kufizuara, për të pranuar e për të mbështetur zhvillimin e vajzës së tyre.

Pavarësisht nga të gjitha arritjet e stafit të shkollës, falë edhe mbështetjes së projektit, nëna e fëmijës i bën thirrje Ministrisë së Arsimit për vendosjen e një mësuesi ndihmës në shkollën, ku aktualisht mësojnë 12 nxënës me aftësi të kufizuara.

Entela, nëna e Santiagos, 6 vjeç nga Vlora, i cili ndjek kopshtin “1 Maji” në Vlorë kishte kuptuar që djali i saj ishte me AK që kur ai ishte dy muajsh. Pas dështimit të përpjekjes së parë për ta integruar, e ëma kishte nisur të studionte vetë për aftësinë e kufizuar. Pas shumë përpjekjeve, Santi (Santiago) pati mundësinë të përfshihej në një kopsht, ku është punuar me shumë kujdes.

Nëna e Santiagos, Entela Beqo kërkon profilizimin e mësuesve ndihmës, ajo kërkon që të ketë projekte të tjera në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Entela falënderoi Save the Children, koordinatoren lokale të këtij projekti, drejtuesen e MEDPAK, për udhëzimet dhe mbështetjen e ofruar pëe të dhe shumë prindërve të tjerë të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara.

## Konkluzione dhe rekomandime

Pas ndarjes së këtyre përvojave emocionuese, konferenca u mbyll me disa rekomandime nga dy drejtuesit e Save the Children në Shqipëri dhe Kosovë, znj. Anila Meço dhe z. Ahmet Kryeziu:

- Janë krijuar disa modele shumë pozitive në të dy vëndet e rajonit dhe ka vend për të shkëmbyer ndërmjet Kosovë dhe Shqipërisë në drejtim të përmisimit të cilësisë në arsimin gjithëpërfshirës. Në Shqipëri ka disa zhvillime të mira, por edhe në Kosovë ka disa elemente interesante për tu vijuar nga Shqipëria.
- Këto ndryshime të arritura në krijimin e praktikave pozitive gjithëpërfshirëse janë të dukshme, por që të jenë të qëndrueshme, duhet të ketë mbështetje financiare nga institucionet qendrore dhe pushteti vendor.
- Është e qartë që janë krijuar disa modele shumë të mira, falë edhe ndërhyrjes së shoqatave lokale me përvojë shumëvjeçare në fushë, siç është MEDPAK, por këto modele të krijuara nuk duhen parë në kuadrin e një projekti. Institucionet vendore dhe politikëbërëse duhet të sigurohen që këto praktika pozitive të mbeten si pjesë e sistemit arsimor, si pjesë e realitetit të prindërve dhe fëmijëve aty ku ata kanë nevojë.
- Gjithëpërfshirja është një proces, i cili nuk mund të gjejë zgjidhje vetëm nga një këndvështrim. Gjithëpërfshirja do të ketë sukses, vetëm nëse do të ketë bashkëpunim ndërinstinucional. Kjo konferencë u fokusua tek arsimit, sepse Save the Children mbështet përfshirjen në arsim të fëmijëve me AK, por kjo nuk do të thotë që gjithëpërfshirja e tyre të shihet vetëm si problem i arsimit.
- Funkcioni i Komisioneve Multidisiplinare duhet të garantohet nga bashkëpunimi ndërinstinucional i Ministrive përgjegjëse (Ministritë së Arsimit dhe Sportit, Ministritë së Mirëqenjes Sociale dhe Rinisë dhe Ministritë së Shëndetësisë) dhe të rregullohet në mënyrë ligjore me rregullore specifike të funksionimit.
- Formula e financimit të arsimit, e në mënyrë të veçantë, formula e financimit të arsimit gjithëpërfshirës e paraqitur nga institucionet e Kosovës është një instrument, i cili do të garantojë implementimin e gjithëpërfshirjes, dhe është model i cili duhet vijuar nga Shqipëria.
- Kualifikimi fillestar i mësuesve për identifikimi e hershëm të fëmijëve me vështirësi zhvillimore dhe kualifikimi i mësuesve në shërbim dhe atyre të ardhshëm mbi arsimin gjithëpërfshirës dhe pedagogjinë speciale mbetet sfida e vendeve, qoftë në Kosovë, qoftë në Shqipëri. Rekomandohet vijimi i modeleve pozitive të ngritura nga projekti mbi zhvillimin e instrumenteve të standardizuara të vlerësimit dhe instrumenteve të tjera ndihmëse, të cilat lehtësojnë identifikimin e hershëm të fëmijëve me vështirësi në arsim dhe garantojnë mbështetjen e tyre cilësore.
- Zhvillimi i vazhduar profesional i mësuesve dhe i mësuesve ndihmës në sistem do të jetë gjithashtu sfida dhe angazhimi kryesor i institucioneve në Shqipëri e Kosovë. Rekomandohet vijimi në nivel vendor i programeve të trajnimit të ngritura nga projekti në bashkëpunim me Universitetin e Bolonjës, Korçës dhe Elbasanit dhe shtrirja e këtyre modeleve pozitive në universitetet e tjera, si dhe krijimi i programeve të tjera mbështetëse për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve.
- Gjithëpërfshirja është proces i gjatë, i cili kërkon angazhimin e të gjithëve, kërkon investim në të gjitha fushat. Vetëm besimi dhe angazhimi i gjithanshëm do të sjellë ndryshimin.

Ky raport përmbledhës nga konferenca rajonale “ Arsimi Gjithëpërfshirës Realitet për çdo Fëmijë” u prodhua në kuadër të projektit “Arsimi Gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të vecanta arsimore në Shqipëri” i financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe e zbatuar nga Save the Children në partneritet me shoqatën MEDPAK dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.



**Save the Children**

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);  
PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929

E-mail: [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org)

[https:// albania.savethechildren.net](https://albania.savethechildren.net)

Savethechildrenal SaveChildrenAlb